



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 24 prot.

Kamëz, më 19.02.2021

V E N D I M

Nr. 21. Datë 19.02.2021

PËR

**“PËRCAKTIMIN E VLERAVE PËR PËRFITUESIT E GRANTIT TË RINDËRTIMIT,  
PËR BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA AKTEKSPERTIZAT E  
THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMESH PËR  
SHEMBJE”**

**Këshilli Bashkiak Kamëz** i mbledhur sot më **19.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.20 Datë 15.02.2021**, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, **Këshillit Bashkiak Kamëz** :

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga Akt ekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS5, sipas tabelës së mëposhtme:

Përbërja familjare	Struktura e banesës individuale	Vlera e grantit të rindërtimit
Deri në 2 anëtarë	1+1	2100000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë
2 deri në 4 anëtarë	2+1	2500000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë
5 e më shumë anëtarë	3+1	2800000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë

2. Shuma e grantit të rindërtimit shpërndahet në dy këste: kësti i parë, në **masën 60 % të vlerës, brenda 10 (dhjetë) ditëve** nga data e nënshkrimit të kontratës depozitohet në llogarinë e Postës Shqiptare. Tërheqja e fondit nga subjekti përfitues do të bëhet në momentin e depozitimit të aktit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi për lejimin e punimeve përkatëse. Pjesa e mbetur e shumës, për grantin e rindërtimit lëvrohet pas verifikimit nga struktura e përkatëse e mbikqyrjes së kontratës që subjekti përfitues ka përfunduar ndërtimin e karabinasë së objektit në përputhje me dokumentet e lejes së ndërtimit.

3. Miratimin e kontratës tip për përfitimin nga granti i rindërtimit për individët ose familjet, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, e cila përmban minimalisht elementet si: afatet që parashikohen në lejet përkatëse të ndërtimit si dhe penalitetet në rastet e mospërbushjes së detyrimit, që përfshijnë por nuk kufizohen edhe në kthimin e grantit kur konstatohen abuzime nga përfituesi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për këto kontrata.

4. Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, sipas parashikimeve të vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave.

5. Mbikëqyrja e zbatimit të kontratës nga përfituesi të kryhet nga strukturat përkatëse të përcaktuara me urdhër të kryetarit të Bashkisë Tiranë. Struktura e mbikqyrjes së zbatimit të kontratës së grantit përmbush ato funksione që ngarkohen në urdhrin e kryetarit dhe kontratën e grantit.

6. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për nënshkrimin e kontratës përkatëse të grantit, e cila përmban minimalisht parashikimet e modelit tip, të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi.

7. Procedurat e parashikuara në këtë vendim mund të zbatohen edhe për aplikuesit e shpallur përfitues të grantit të rindërtimit me vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak, për të cilët nuk ka filluar ende procesi i ndërtimit të banesave të reja.

8. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Rindërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Çështjeve ligjore dhe Liçensave, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

9. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Zv/Kryetar i Këshillit**

